



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 01.04.2019

Ref.: 545/19_D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 65-të, të mbajtur më 13 mars 2019, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa Nr.373/19H, datë 11.02.2019 e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filologjisë, si e bazuar.
- II. Anulohet vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.183/19D, datë 11.02.2019.
- III. Aprovohet aplikacioni i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit Filologjik, për riakreditim të programit të studimit, Orientalistikë: Studime Kulturore orientale, MA, 60 ECTS.

Arsyetimi

Me qëllim të plotësimit të kriterëve formale për staf akademik sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), KSHC bazuar në pikën 2.1. Neni 4 i Udhëzimit Administrativ për Akreditim (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018) dhe Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG 2015), në mbledhjen e 63-të, mbajtur më 27 shkurt 2019, vendosi që Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të iu lejohet/pranohet riorganizimi i stafit akademik bartës të programeve, të deklaruar në afatin kohor të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018).

KSHC me vendim Nr.183/19D, datë 11.02.2019 ka refuzuar aprovimin e aplikacionit për programin e studimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit Filologjik: Orientalistikë: Studime Kulturore orientale, MA, 60 ECTS.

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filologjik, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.183/19D, datë 11.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë 3 mars 2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit


të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Përmes kësaj ankesa, Universiteti ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth staf akademik për programin e studimit i cili ka qenë objekt i trajtimit me vendimin e KShC-së Nr.183/19D, datë 11.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 65-të të KShC-së, të mbajtur me 13 mars 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa është e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës i plotësojnë kushtet për të qenë bartës të programeve të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe iniciimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Filologjisë;
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë